



Data: 23 mars 2018

Buletin Informativ

Nr.2, 2018

Projekti suedez SCPA, biçikleta për punonjësit e policisë së zonave urbane në kuadër të forcimit të Policimit në Komunitet



Në kuadër të riorganizimit të D.V.P Elbasan dhe mbështetjes që ofrohet nga projekti SCPA, më datë 13 mars 2018 u organizua një ceremoni për të diskutuar propozimet e reja dhe për dorëzimin e 5 biçikletave profesionale së bashku me aksesoret e tjerë. Biçikletat janë destinuar për përdorim nga Oficerët e Policimit në Komunitet në zonat e reja policore në qytetin e Elbasanit. Kjo mbështetje synon forcimin e rolit të OPK-ve dhe rritjen e bashkëpunimit me publikun. Gjithashtu, kjo do të shërbejë për të kontrolluar më mirë territorin dhe për të dhënë shembullin e "transportit të gjelbër" brenda qytetit. Në këtë ceremoni, ishte e pranishme Zv/ Ministria e Brendshme, Znj. Romina Kuko, Drejtori DVP-së, Altin Qato, dhe përfaqësuesit e projektit SCPA. Drejtori i Policisë Vendore, Z. Qato, gjatë fjalës së tij ka shpjeguar të rejat e ristrukturimit të Drejtorisë si dhe ka vlerësuar dhurimin e biçikletave për punonjësit e Policisë së zonave urbane, çka do të sjellë ndihmesë dhe përmirësim në punën e tyre. Ne mes të tjerash, ai u shpreh:

"Ne prej kohësh po punojmë me dy kolegët tanë të projektit suedez SCPA. Me këtë rast unë dua të falënderoj Ekipin Menaxhues të Programit për mbështetjen e ofruar, sepse realisht kemi bërë shumë punë bashkë. Fillimisht, kemi bërë gjithë studimin dhe analizimin e problemeve, kemi identifikuar gjithë problemet së çfarë nuk shkon në strukturë dhe pastaj kemi bashkëpunuar për të dhënë zgjidhjet.

Ne e kemi shpjeguar edhe më parë, strukturën. Ajo ka një risi me shtimin e sektorëve të rinj siç është analiza strategjike, planifikimi, monitorimi dhe vlerësimi. Po kështu është edhe sektori tjetër i shërbimeve të specializuara. Kemi venë theks të veçantë tek policimi në komunitet dhe për këtë janë bërë procedurat pothuajse nga e para. Përveç këtyre, bashkë me kolegët kemi identifikuar disa probleme logjistike që janë të nevojshme, kemi rënë dakord të bëjmë një reformë të plotë tek salla operative, për shkak se edhe në strukturë ne po e ngremë nivelin e sallës nga nivel seksioni me shërbim turni me gradën N/komisar, në nivel sektori me përgjegjës me gradën Kryekomisar dhe shërbim turni me gradën Komisar, në mënyrë që t'i japim një rol tjetër drejtimi, koordinimi dhe kështu punonjësi i shërbimit të mos jetë në rolin e vjetër të oficerit të rojës, por një oficer që menaxhon situatat që ndodhin.

Për patrullimet në zonë zgjedhëm mjetin biçikletë sepse e kuptojmë që ka një lloj shkëputjeje të Policisë me komunitetin. Ne synojmë edhe krijimin e një kontakti efikas me Bashkinë për të ngritur zyrat e punonjësve tanë të Policisë, pranë njësive administrative, për të qenë më pranë qytetarëve".

Znj. Kuko në fjalën saj vlerësoi punën sistematike disa-mujore edhe serioze në lidhje me ristrukturimin e Drejtorisë, duke i dhënë një fokus të veçantë Komisarariatit dhe punës së policisë në terren. Ajo theksoi se kjo është me të vërtetë për t'u përgëzuar sepse në radhë të parë shënon ndryshim mentaliteti.



Një falënderim i veçantë shkon edhe Projektin Suedez të Policimit në Komunitet, i cili është duke asistuar si Ju, ashtu edhe neve në Ministrinë e Brendshme, në mënyrë që kjo reformë të jetë në linjë me prioritetin e kontrollit më të mirë të territorit dhe të marrëdhënies së re që duam të vendosim me qytetarët. Është shumë e rëndësishme që të vazhdojmë të ruajmë të njëjtin ritëm reforme edhe në qytete të tjera. Elbasani është qyteti i parë, por ne kemi shpresë sigurisht që ta zbatojmë edhe në qytete të tjera. E para është rritja e cilësisë së shërbimit të Policisë ndaj komunitetit, njohja nga komuniteti e Oficerëve të Policimit në Komunitet, marrëdhënia që do të vendosim me aktorët e tjerë lokalë, por gjithashtu edhe forumet qytetare për sigurinë publike, në të cilat do të jemi të gjithë bashkë për të diskutuar për çështjet e sigurisë.

Hapja e Zyrave të Policisë pranë Njësite Administrative për një shërbim më të mirë policor për qytetarët

Në vazhdim të punës për rishikimin e DVP Elbasan jo vetëm në strukturë por edhe në filozofi, në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe projektin suedez SCPA, krijohen zyra të reja në zonat policore për të qenë sa më afër problemeve që hasen në komunitet. Ambientet janë vënë në dispozicion nga Bashkia Elbasan. Zv/Ministrja e Brendshme, Znj. Kuko, së bashku me Drejtorin e Policisë Vendore dhe përfaqësues të pushtetit vendor, ka vizituar zyrën në një nga zonat policore në qytet.



Z. Qato vlerësoi bashkëpunimin me Bashkinë për të ngritur zyrat e punonjësve të Policisë sipas zonave policore. Me strukturën e re, ka një përpjekje për ndarjen e zonave policore në përputhje sa më të afërt me ndarjen administrative. Kemi filluar të identifikojmë këto ambiente, të cilat po i përgatisim së bashku me Bashkinë, dhe me projektin suedez, për të bërë të mundur që të kemi zyra me kushte pune komode për punonjësit tanë, si dhe këta të fundit të jenë me afër problemeve dhe shqetësimeve të njerëzve. Në çdo zonë policore do të kemi një patrullë në turn, e cila përbëhet nga dy veta; kemi dy inspektorë krimesh; Inspektorë të Rendit dhe të policimit në komunitet kemi tre, dhe të gjithë së bashku do të kenë një zyrë të vetme.

Patrulla e Përgjithshme është përgjegjëse për këtë territor dhe në çdo moment që ka nevojë për të ballafaquar, për të bërë ndonjë verifikim, për të komunikuar me inspektorët e zonës ose inspektorët e krimeve, ata vijnë dhe paraqiten në këtë zyrë. Instruktazhin grupi e merr në Komisarjat. Punonjësit e policisë në

zonën policore nuk ndërrojnë territorin, por ndërrojnë turnet.

Në zyrat e reja punonjësit e Policisë si dhe të administratës vendore njihen me shqetësimet dhe problemet e komunitetit, ku secili merr përsipër zgjidhjen e problemeve sipas kompetencave. Me këtë model krijojmë raportin me tre aktorët: 1. qytetarët të cilëve ne i shërbejmë, 2. Administrata që i shërben çfarë ka të bëjë me pushtetin vendor dhe 3. Policia për sigurinë. Bashkërisht i zgjidhim më lehtë problemet e paraqitura.



Ndërsa, Znj Kuko theksoi se: "Kjo është zyra e parë që ne inaugurojmë, duhet ta dini që jeni të parët, jeni pararoja për këtë marrëdhënie që është shumë e rëndësishme. Dua të falënderoj bashkinë për dashamirësinë që keni treguar, por edhe për partneritetin që po tregoni ndaj Policisë.

Sepse me të vërtetë që Policia ka përgjegjësinë e saj, detyrat për sigurinë dhe rendin publik, por e vetme nuk mund t'ia dalë dot. Kështu që pa ndihmesën dhe mbështetjen tuaj dhe të qytetarëve është e vështirë."

Me tej Z. Qato shpjegoi se ky ndryshim ka një impakt në zhvillimin e konceptit të ekipit, pra të frymës së skuadrës. "Kjo është një skuadër me 15 veta. Në çdo moment ato janë dy punonjës në turn, por mund të bashkohen për një

situatë që është e rënduar ose ka ankesa komuniteti, që një specialist i rendit të mos e ndiejë veten i vetëm. Dhe risia është që nuk kemi konceptin "shef". Këtu nuk ka shef. Të gjithë janë të barabartë dhe janë të detyruar të diskutojnë bashkë për zgjidhjen. Secili ka punën e vet, e diskutojnë bashkë, e zgjidhin bashkë.

Në këtë mënyrë e ndiejnë të gjithë përgjegjësinë, ndaj e kemi bërë këtë zyrë. Inspektorët e Policimit në Komunitet dhe Inspektorët e Krimeve e kanë zyrën në Drejtori ose në Komisarjat, por në këtë territor ato do të jenë bashkë.

Në përputhje sa më të afërt me 6 njësite administrative të qytetit do të ketë dhe një ndarje të zonave policore. Njësia 4 është njësia kryesore realisht edhe për shkak të pozicionit gjeografik që ka.